

VENDIM
Nr. 134, datë 18.2.2005

**PËR NGRITJEN E SEKRETARIATIT TË KOMITETIT KOORDINUES TË
MINISTERIALIT TË MBROJTJES SË EUROPËS JUGLINDORE (SEDM-CC) DHE
TË KOMITETIT DREJTUES POLITIKO-USHTRAK/FORCËS PAQUERUAJTËSE
SHUMËKOMBËSHE TË EUROPËS JUGLINDORE (PMSC/MPFSEE) NË
SHQIPËRI**

(Ndryshuar me Vkm nr. 845, datë 16.11.2005)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4 të marrëveshjes dhe të protokollit shtesë “Për krijimin e Forcës Shumëkombëshe të Europës Juglindore”, ratifikuar me ligjin nr.8544, datë 4.11.1999, të nenit 21 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 7 të ligjit nr.9339, datë 21.12.2004 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e Sekretariatit të Komitetit Koordinues, *ad-hoc*, të Ministerialit të Mbrojtjes së Europës Juglindore (SEDM/CC) dhe të Komitetit Drejtues Politik-Ushtarak/Forcës Paqeruajtëse Shumëkombëshe të Europës Juglindore (PMSC/MPFSEE) në Shqipëri, në varësi administrative të Ministrisë së Mbrojtjes, për bashkërendimin e veprimtarisë së SEDM/CC dhe të PMSC/MPFSEE dhe për zbatimin e vendimeve politike që do të marrin e të programeve që do të miratojnë. Sekretariati i SEDM/CC dhe i PMSC/MPFSEE të funksionojë për një periudhë dyvjeçare, ku veprimtaria parapërgatitore të fillojë më 1 mars 2005, ndërsa veprimtaria zyrtare më 1 korrik 2005, dhe të përfundojë më 31 korrik 2007.

2. *Sekretariati i SEDM-CC-së dhe PMSC/MPFSEE-së të përbëhet nga 13 veta, civilë dhe ushtarakë, nga personeli i Ministrisë së Mbrojtjes:*

- a) kryetari të jetë zëvendësministri i Mbrojtjes;*
- b) këshilltari të jetë civil ose ushtarak;*
- c) shefi i sekretariatit të jetë ushtarak, në nivel drejtor drejtorie;*
- d) shefi i sektorit PMSC-së të jetë ushtarak;*
- d) dy specialistë për marrëdhëniet ndërkombëtare në sektorin e PMSC-së, të jenë ushtarakë ose civilë, njëri prej të cilëve të jetë përkthyes i gjuhës angleze;*
- dh) shefi i sektorit të SEDM-CC-së të jetë ushtarak;*
- e) dy specialistë për projektet e SEDM-së në sektorin e SEDM-CC-së, të jenë ushtarakë ose civilë;*
- ë) shefi i sektorit të protokollit dhe administratës të jetë ushtarak;*
- f) specialist dhe koordinator i SEDM-së në sektorin e protokollit dhe administratës, të jetë ushtarak ose civil;*
- g) shefi i zyrës së planfinancës të jetë ushtarak ose civil;*
- gj) specialist, llogaritar ose arkëtar në zyrën e planfinancës të jetë ushtarak ose civil.*

Shtesat në personelin e sekretariatit të përfshihen brenda numrit limit të punonjësve të Ministrisë së Mbrojtjes.

3. Ministria e Mbrojtjes të sigurojë mjediset dhe pajisjet e nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë dhe për funksionimin e Sekretariatit.

4. Kryetari, shefi i Sekretariatit, oficeri i shtabit për operacionet, oficeri i shtabit për logjistikën, oficeri i shtabit për protokollin dhe një specialist civil të jenë në detyrë të përhershme dhe ta fillojnë detyrën më 1 mars 2005, ndërsa pjesa tjetër e personelit më 1 korrik 2005.

5. *Pagat e personelit të sekretariatit të jenë të njëjta me pozicionet e administratës publike, si më poshtë vijon:*

- a) këshilltari me atë të drejtorit të drejtorisë;*
- b) specialistët civilë të paguben me pagën e specialistit të nivelit të lartë;*

c) ushtarakët të paguhen sipas gradës dhe funksionit.

Punonjësit civilë të sekretariatit e përfitojnë këtë pagë deri në datën e përfundimit të kryesimit nga Shqipëria të sekretariatit të SEDM-së.

Ushtarakët aktivë, të cilët bien në pagë për shkak të emërimit në funksionet e përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, trajtohen me shtesë “ruajtje page” gjatë kohës së qëndrimit në këtë detyrë.

6. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2005, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.

7. Ministrisë së Mbrojtjes, në buxhetin e vitit 2005, zëri “Mallra e shërbime”, t’i shtohet fondi prej 10 000 000 (dhjetë milionë) lekësh, për përballimin e shpenzimeve për organizimin e takimeve e të veprimtarive të tjera, brenda dhe jashtë vendit.

8. Fondi prej 10 000 000 (dhjetë milionë) lekësh të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

9. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Financave dhe Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano